

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5402
E mërkurë, 14 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Qeveria ndan 600 mijë euro për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë ■ FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

TRUMPI URON THAÇIN PËR DHJETËVJETORIN E PAVARËSISË ■ F. 2

SALI BISLIMI: PLK-JA DO TË ANGAZHOHET QË KOSOVA TË INTEGROHET NË BE ■ F. 6



KRYEMINISTRI MALAZEZ VJEN SOT NË KOSOVË ■ F. 5

EKONOMI

THAÇI: TREGU YNË DUHET TË MBUSHET ME PRODHIME 'MADE IN KOSOVA' ■ F. 9

AUTOSTRADA PRISHTINË - GJILAN DO TË KUSHTOJË 88 MILIONË EURO ■ F. 8

KULTURË

RRUGËTIMI DREJT VARGJEVE POETIKE ■ F. 15



Mr. Kosovare KRASNIQI

SPORT

DEBUTIM I SUKSESSHËM I TAHIRIT NË 'PYEONGCHANG 2018' ■ F. 14

TREPÇA '89 - LLAPI, DERBI I KUPËS ■ F. 14



FLET PËR "EPOKËN E RE", KADRI KASTRATI ■ FAQE 4-5

Ushtria duhet të formohet këtë vit

Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, u ka bërë thirrje institucioneve të vendit që në këtë përvjetor jubilar të shpalljes së pavarësisë ta përshpejtojë procesin e transformimit të FSK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka deklaruar se institucionet e Kosovës, së bashku me NATO-n dhe

palët e tjera, duhet të ulen dhe ta hartojnë një strategji e cila parasheh formimin e shpejtë të Forcave të Armatosura të Kosovës. Ai ka thënë se formimi i ushtrisë së Kosovës është bërë nevojë e kohës. Ish-komandanti i FSK-së ka theksuar se me formimin e Forcave të Armatosura, me rinimin e Policisë së Kosovës dhe me profesionalizimin e mëtejshëm të inteligjencës, sfidat në fushën e sigurisë do të jenë shumë më të lehta

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SLOVENISË, BORUT PAHOR, KA MBAJTUR FJALIM PARA DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Pahori kërkon nga Kosova ta ratifikojë demarkacionin

Presidenti i Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, u është drejtuar të martën me një fjalim deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ai i ka inkurajuar deputetët ta zgjidhin problemin e kufirit me Malin e Zi në mënyrë që

Kosova të bëhet pjesë e BE-së. Po ashtu, ai ka thënë se i mbështet përpjekjet e Kosovës dhe Serbisë që t'i zgjidhin problemet e hapura përmes negociatave të mbështetura nga BE-ja ■ FAQE 7



Veseli ia dhuron flamurin e Republikës së Kosovës veprimtarit Adem Demaçi

Askush më shumë prej të gjallëve sesa Adem Demaçi nuk bart mbi supe sakrificën në rrugën për liri dhe pavarësi. "Një pjesë e historisë së Kosovës është historia e jetës së

tij. Një takim emocional me bacën Adem, në konakun e tij, për ta falënderuar dhe për t'ia uruar 10-vjetorin e pavarësisë", ka thënë kryeparlamenti Veseli. ■ FAQE 6

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Presidenti Trump uron Thaçin për dhjetëvjetorin e pavarësisë

Në urimin e presidentit Trump, të cilin ambasadori amerikan Greg Delawie ia dorëzoi të martën presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, thuhet se gjatë dhjetë vjetëve të kaluar Kosova ka bërë hapa të mëdhenj për forcimin e sovranitetit të saj dhe të demokracisë shumënike, dhe teksa mbetet punë për t'u bërë, ne duartrokasim përparimin tuaj

PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka uruar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në prag të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. "Gjatë dhjetë vjetëve të kaluar Kosova ka bërë hapa të mëdhenj për forcimin e sovranitetit të saj dhe të demokracisë shumënike. Teksa mbetet punë për t'u bërë, ne duartrokasim përparimin tuaj", thuhet në urimin e presi-

dentit Trump, të cilin ambasadori amerikan Greg Delawie ia dorëzoi të martën presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. "Derisa shteti juaj po hyn në dekadën e dytë të shtetësisë, Shtetet e Bashkuara janë të vendosura ta ndihmojnë Kosovën të ndërtojë themele të forta të parimeve të përbashkëta demokratike, bashkëpunimit rajonal dhe sundimit të së drejtës. Duke vepruar kështu, Kosova do të ndërmarrë hapa

të mëtejshëm drejt integritimit në komunitetin perëndimor të kombeve. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shohin Kosovën si partnere të rëndësishme", thuhet në urimin e presidentit amerikan, Donald Trump. Ndërkaq presidenti Thaçi, duke falënderuar presidentin Trump për urimet dhe përkushtimin e tij për Kosovën, shkroi në rrjetet sociale se populli i Kosovës është me shumë me fat që ka një shtet mik kaq të fuqishëm si Shtetet e



Bashkuara. Kosova shpalli pavarësinë e saj dhjetë vjet më parë me

mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian.

Hoxhaj: Kompletimi i sovranitetit bëhet me anëtarësimin e Kosovës në OKB

PRISHTINË, 13 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, po qëndron në Nju Jork, me ç'rast ka marrë pjesë në panelin e organizuar nga Instituti Amerikan "Independent Diplomat" dhe Konsullata e Kosovës në Nju Jork për nder të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se në 10 vjetët e fundit Kosova është dëshmuar si storie suksesi në ndërtimin e shtetit nga themelet. "Dekada e parë e shtetësisë ka nxjerrë si rezultat një shoqëri demokratike, shumënike dhe sekulare. Në planin e brendshëm janë



ndërtuar institucionet politike shtetërore, është krijuar baza për zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, janë bërë reforma të

shumta në fusha të tjera të jetës, duke filluar nga arsimi, shëndetësia, drejtësia e deri tek ambienti", ka thënë Hoxhaj. Ai ka folur edhe për dimensionin

e dytë të shtetndërtimit të Kosovës, duke theksuar rëndësinë e anëtarësimin të Kosovës në OKB. "Dimensioni i dytë i shtetndërtimit është integrimi i Kosovës në bashkësinë dhe institucionet ndërkombëtare, pra njohja dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Sot janë 115 shtete që e kanë njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran dhe janë 67 organizata ndërkombëtare ku Kosova është anëtare. Kosova ka marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe zbatimit të saj, si një proces i rëndësishëm për integrimin e

Kosovës në BE", është shprehur Hoxhaj. "Duke festuar 10-vjetorin e pavarësisë dhe duke nxjerrë një bilanc se çfarë është e çka mbetet për t'u bërë, Kosovës i duhet qartësi strategjike për të ardhmen e saj. Kosova duhet t'i adresojë dy sfida: E para, është kompletimi i sovranitetit përmes anëtarësimin në OKB, një proces ky i vështirë, por i pandalshëm. Dhe, e dyta: vendi duhet të lëvizë nga përmbyllja e shtetndërtimit, në fazën e ndërtimit të një shoqërie dhe ekonomie të zhvilluar, që do ta bëjë të mundur anëtarësimin e Kosovës edhe në BE dhe në NATO", ka theksuar Hoxhaj.

BE-ja bashkon politikën shqiptare, kërkohet datë për negociatat

TIJANË, 13 SHKURT - Në sytë e eurodeputetëve, mazhoranca dhe opozita kanë gjetur dakordësinë dhe dolën me rekomandime të përbashkëta në përfundim të mbledhjes dyditore të Komitetit Ndërparlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri. "Kemi një dakordësi të plotë mazhorancë-opozitë, ku rekomandohet hapja e negociatave dhe caktimi i një date. Lajmi i mirë është që më në fund kemi një dokument të përbashkët edhe me opozitën. Jemi të gjithë

bashkë për të punuar për Shqipërinë evropiane", deklaroi Taulant Balla. Kjo ishte mbledhja e 12 e këtij komiteti. Në dy mbledhjet paraardhëse, pra në atë të 11-të dhe 10 nuk ka pasur konsensus dhe punimet e këtij Komiteti nuk kanë dalë me një deklaratë të përbashkët. Gjatë punimeve të së hënës Monica Macovei, që drejton delegacionin e parlamentarëve evropianë, u kërkoi politikanëve në Tiranë t'i lënë mënjane sherrat dhe të dialogojnë. Pas kësaj thirrjeje, Taulant Balla

që drejton delegacionin shqiptar përsëriti edhe një herë ftesën drejtuar opozitës për një pakt kombëtar për Evropën. Rezultatet e reformës në drejtësi mbeten thelbësore, shpjegoi ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin, ndërsa shtoi se efektet e para po ndihen. "Ne kemi filluar t'i shikojmë produktet e para të ndryshimit të sistemit. Ne i shohim rezultatet e para të procesit të Vettingut edhe përpara seancave më publike, me dorëheqjet e ditëve të fundit dhe ne do të



vijojmë të kërkojmë rezultate", u shpreh Vlahutin. Në fjalën e saj, deputetja e PD, Jorida Tabaku, kërkoi edhe një

herë shpjegim se përse opozita nuk është përfshirë në takimin e fundit të Këshillit të Stabilizim Asociimit.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria ndan 600 mijë euro për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë

Kabineti qeveritar ka ndarë 600 mijë euro për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Po ashtu, Qeveria ka themeluar edhe Këshillin Organizativ për manifestimin gjithëpopullor për shënimin e Epopesë së UÇK-së, me ç'rast ka ndarë 100 mijë euro për këtë ngjarje, e cila do të organizohet nën përkujdesjen e kryeministrit Ramush Haradinaj

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 SHKURT - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 600 mijë eurosh për realizimin e programit të Këshillit Organizativ për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës. Këto mjete janë ndarë nga shpenzimet e paparashikuara dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kategorinë e subvencioneve dhe transferimeve. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Financave janë obliguar ta zbatojnë këtë vendim.

Gjithashtu, në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar është themeluar edhe Këshilli Organizativ për manifestimin gjithëpopullor për shënimin e Epopesë së UÇK-së, me ç'rast janë ndarë mjete financiare në vlerë prej 100 mijë eurosh. Kjo ngjarje do të organizohet nën përkujdesjen e kryeministrit Ramush Haradinaj.

Ndërkohë në hapje të mbledhjes, kryeministri Ramush Haradinaj ka njoftuar kabinetin qeveritar për vizitën në Shtetet

e Bashkuara të Amerikës, të cilën e ka vlerësuar të suksesshme. Ai ka treguar se delegacioni i Kosovës ka pasur takime të rëndësishme dhe ka marrë një mesazh të fuqishëm të autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës se do të vazhdojë përkrahja dhe mbështetja e ecjes së Kosovës përpara. "Ngjarja e parë ishte pritja në 10-vjetorin e pavarësisë. Me rëndësi ishte që në këtë pritje ishte një nivel i lartë i institucioneve amerikane. Ajo që më bëri përshtypje në këtë pritje ishte qëndrimi i qartë se Amerika vazhdon ta përkrahë Kosovën si shteti i pavarur. Gjithashtu, kam pasur takim me drejtorin e CIA-s. Kemi biseduar për sfidat e sigurisë në Kosovë e rajon. Po ashtu, kemi pasur një vizitë në Iowa. Në këtë vizitë dhe në bisedat që kemi pasur na inkurajojnë t'i kryejmë punët e shtëpisë si Kosovë", ka deklaruar Haradinaj.

Kabineti qeveritar ka miratuar nismat e negociimit të marrëveshjeve të granteve nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) si dhe nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Po ashtu, Qeveria ka miratuar edhe



Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës. Ky projektligj plotëson dhe ndryshon ligjin ekzistues dhe është në përputhje me legjislacionin evropian. Aprovimin e Qeverisë e ka marrë edhe Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Rregullorja përcakton organizimin e brendshëm të ministrisë, pas riorganizimit dhe zgjerimit të përgjegjësisë të saj, pas konstituimit të Qeverisë në shtator të vitit 2017.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe raportin e pasqyrave preliminare financiare për ekzekutimin e buxhetit gjatë vitit 2017. Ky raport procedohet

në Kuvendin e Kosovës për informim. Sipas raportit, të hyrat në buxhet gjatë vitit 2017 kanë qenë në total 1 miliard e 920 milionë euro dhe janë për tetë për qind më të larta se në vitin paraprak. Shpenzimet kapin shumën 1 miliard e 835 milionë euro dhe janë më të

larta për katër për qind se në vitin paraprak.

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka themeluar edhe Komitetin Drejtues Ndërmëntor për zhvillimin e projektit "Autostrada Istog - Pejë-Deçan - Gjakovë - Prizren".

Haradinaj merr vendim për vendosjen e flamurit shtetëror "Te rrethi"

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ka marrë vendim që në vendin e quajtur "Te rrethi" në hyrje të Prishtinës të vendoset flamuri i Kosovës. "17 shkurti është data më e madhe e Kosovës, dhe ajo do të nderohet në mënyrën më dinjtoze", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka kërkuar nga të gjithë të përmbahen nga debatet emocionale dhe vëmendja t'i adresohet shënimin me dinjitet të përvjetorit jubilar të shpalljes së pavarësisë.

Limaj: Mbrojtja e Kompleksit Memorial 'Adem Jashari', prioritet i Qeverisë



PRISHTINË, 13 SHKURT - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka njoftuar të martën kabinetin qeveritar për situatën e rëndë të Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, nga mungesa e investimeve për konservimin e objekteve të kullave të Jasharëve. Ai ka thënë se kjo çështje është nevojë urgjente dhe se nuk ka prioritet më të madh për Qeverinë sesa Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. "Është nevojë urgjente konservimi i Kompleksit Memorial në Prekaz. Qeveria e Kosovës duhet ta japë kontributin e saj. Ideja jonë është që në kon-

servim të marrë pjesë Qeveria e Kosovës dhe të shpëtohet ky memorial. Besoj se shumë shpejt duhet të vijmë me një ide konkrete. Duhet ta kemi një qasje tjetër për realizimin e këtyre detyrave. Deri në mbledhjen e ardhshme do të analizohet situata e krijuar dhe do t'i rekomandohen Qeverisë hapat që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e këtij kompleksi që shënon një vlerë sublimë të luftës çlirimtare", është shprehur Limaj. Ndërsa ministri Bedri Hamza ka thënë se Ministria e Financave do të ndajë buxhet të nevojshëm për kompleksin në Prekaz.

Flet për "Epokën e re", Kadri Kastrati

Ushtria duhet të form

Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, u ka bërë thirrje institucioneve të vendit që në këtë përvjetor jubilar të shpalljes së pavarësisë ta përshpejtojnë procesin e transformimit të FSK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka deklaruar se institucionet e Kosovës së bashku me NATO-n dhe palët e tjera duhet të ulen dhe ta hartojnë një strategji e cila parashih formimin e shpejtë të Forcave të Armatosura të Kosovës. Ai ka thënë se formimi i ushtrisë së Kosovës është bërë nevojë e kohës. Ish-komandanti i FSK-së ka theksuar se me formimin e Forcave të Armatosura, me rinimin e Policisë së Kosovës dhe me profesionalizimin e mëtejshëm të inteligjencës, sfidat në fushën e sigurisë do të jenë shumë më të lehta

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka ftuar institucionet e Kosovës ta përshpejtojnë procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Ai ka thënë se formimi i ushtrisë duhet të ndodhë brenda këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka deklaruar se institucionet e Kosovës, së bashku me NATO-n dhe palët e tjera, duhet të ulen dhe ta hartojnë një strategji e cila do të mundësonte që më në fund të fillojë transformimi i FSK-së. "Kjo strategji duhet të hartohet gjatë këtij viti në mënyrë që Kosova ta fillojë

transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Vetëm në këtë mënyrë do të plotësohet arkitektura e sigurisë në Kosovës", ka thënë Kastrati. Ai ka shtuar se formimi i Forcave të Armatosura të Kosovës është bërë nevojë e kohës dhe, sipas tij, kjo forcë vetëm do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit në rajon. "Me formimin e Forcave të Armatosura, me rinimin e Policisë së Kosovës dhe me profesionalizimin e mëtejshëm të inteligjencës, sigurisht se sfidat në fushën e sigurisë me të cilat do të përballlet Kosova do të jenë shumë më të lehta", ka thënë Kastrati. Ish-komandanti i FSK-së ka thënë se gjatë këtyre dhjetë vjetëve të shtetësisë gjendja e sigurisë ka qenë stabile.

"Epoka e re": Z. Kastrati, Kosova po i rrumbullakon dhjetë vjet shtet. Si do ta vlerësonit gjendjen e sigurisë dhe punën e institucioneve të kësaj fushe gjatë kësaj periudhe kohore?

Kastrati: Në përgjithësi gjatë kësaj periudhe kohore situata e sigurisë ka qenë e mirë dhe në nivelin e duhur, pavarësisht se siguria e Kosovës gjatë këtyre dhjetë vjetëve është sfiduar nga faktorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Institucionet tona të sigurisë brenda kapaciteteve që kanë pasur kanë bërë punën e duhur, mirëpo nuk duhet të vetëkënaqen me këtë situatë. Institucionet tona të sigurisë duhet të punojnë më shumë për të ecur përpara drejt përmirësimit të gjendjes së sigurisë në vend.

"Epoka e re": Nga kush është sfiduar më shumë siguria e Kosovës gjatë këtyre dhjetë vjetëve?

Kastrati: Siguria e Republikës së Kosovës është sfiduar nga shumë faktorë. Do t'i veçoja vetëm dy faktorët më kryesorë: ndikimi rus dhe ndikimi i Serbisë. Këta dy faktorë çdoherë janë munduar ta destabilizojnë Kosovën, pastaj të proklamohet se ky shtet nuk është në gjendje të ofrojë siguri. Pra, të pengohet integrimi i Kosovës në strukturat euroatlantike. Po ashtu, shkruaja e qytetarëve të Kosovës për të luftuar në Irak dhe Siri ka cenuar sigurinë e vendit. Kurse siguria e brendshme është sfiduar edhe nga partitë politike, me organizimin e demonstratave të dhunshme duke sulmuar institucionet shtetërore.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh edhe rrjedhat globale, në të ardhmen kush mund ta cenojë sigurinë e Kosovës?

Kastrati: Sigurisht se përsëri sfidues të shtetit të Kosovës do të jenë Serbia dhe Rusia. Ndërtimi i bazës ruse në Nish tregon për këto qëllime. Ndonëse ajo është emëruar si bazë emergjente, dihet se ajo bazë udhëhiqet nga ushtarakët rusë dhe ka për qëllim kryesor destabilizimin jo vetëm të Kosovës, por edhe të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, derisa ky i fundit nuk ishte anëtar i NATO-s. Qëllimi i kësaj baze është pengimi i rajonit që të ecë drejt anëtarësimit në NATO. Pra, ky do të jetë një rrezik potencial edhe në të ardhmen për Kosovën derisa ta formojë ushtrinë e saj dhe të anëtarësohet në NATO.

ohet këtë vit



"Epoka e re": Kosova deri më tani ka ndërtuar të gjitha institucionet e saj të sigurisë, përveç hallkës së fundit që është transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura. Ku duhet ta kenë fokusin institucionet tona tani e tutje?

Kastrati: Shteti i Kosovës duhet të investojë më shumë në Policinë e Kosovës, sepse më herët kjo polici ka qenë prej me të reja dhe më profesionale në rajon, ndërsa tani jemi dëshmitarë se kjo polici është duke u plakur. Në këtë drejtim kisha sugjeruar që institucionet tona ta miratojnë një ligj që pjesëtarët e policisë të pensionohen sikurse pjesëtarët e FSK-së në moshën 55-vjeçare. Në këtë mënyrë do të hapej rruga që të rekrutohen më shumë të rinj. Po ashtu, duhet të investohet më shumë në pajisje dhe në trajnime

më moderne për Policinë e Kosovës, që kjo të jetë e gatshme të përballot me të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë.

Gjithashtu, institucionet e Kosovës duhet të ulen dhe të diskutojnë së bashku me NATO-n dhe të gjitha palët e tjera që janë në lojë, që ta hartojnë një strategji e cila do të mundësonte që më në fund të fillojë transformimi i FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Kjo është një prej shtyllave kryesore që Kosovën do ta bënte të ndihë shumë më e sigurt në të gjitha fushat.

"Epoka e re": Brenda çfarë kohe do të duhet të hartohet kjo strategji dhe kur do të duhet të fillojë transformimi i FSK-së në ushtri?

Kastrati: Kjo strategji duhet të hartohet gjatë këtij viti në mënyrë që Kosova ta fillojë transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës. Vetëm në këtë mënyrë do të plotësohet arkitektura e sigurisë në Kosovës. Dihet tashmë se formimi i Forcave të Armatosura është bërë nevojë e kohës dhe kjo forcë vetëm do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit në rajon. Me formimin e Forcave të Armatosura, me rinimin e Policisë së Kosovës dhe me profesionalizimin e mëtejshëm të inteligjencës, sfidat në fushën e sigurisë do të jenë shumë më të lehta.

"Epoka e re": Po anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë të sigurisë, sa do t'i ndihmonte institucionet tona që t'i parandalojnë rreziqet në aspektin e sigurisë?

Kastrati: Mendoj se Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Punëve të Brendshme duhet të punojnë dhe duhet ta kenë një strategji të qartë se si ta menaxhojnë anëtarësimin në këto organizata rajonale-ndërkombëtare, duke bashkëpunuar ngushtë me miqtë tanë ndërkombëtarë. Ne e dimë se anëtarësimi në Interpol është me tepër vendim politik, sepse Kosova tashmë i ka përmbushur të gjitha kriteret që kërkohen nga kjo organizatë. Por, ne duhet të punojmë ngushtë me partnerët tanë strategjikë që të jemi pjesë e këtyre mekanizmave. Tekefundit, anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë është interes i vet bashkësisë ndërkombëtare, sepse ne jemi në një pozitë strategjike në Ballkan dhe Kosova mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e fenomeneve të ndryshme negative, si terrorizmi, krimet e organizuara dhe kontrabandimi i qenieve njerëzore.

"Epoka e re": Z. Kastrati, si duhet të veprojnë institucionet tona në këtë përvjetor jubilar të shtetësisë. Duhet të ndërmarrin masa shtesë për ngritjen e sigurisë?

Kastrati: Absolutisht po. Jo vetëm për këtë përvjetor të pavarësisë, por për çdo festë e cila mbahet në Kosovë jam i bindur se inteligjenca jonë dhe policia e Kosovës paraprakisht i kanë planet e tyre operative, në mënyrë që të marrin masa paraprake për të mos lejuar ndonjë akt të mundshëm, i cili do të mund të prishte sigurinë në vend. Po e ritheskoj se Serbia dhe Rusia çdoherë janë në gjendje gatishmërie për ta destabilizuar Kosovën dhe për të treguar në arenën ndërkombëtare se gjoja institucionet e Kosovës nuk janë të gatshme ta menaxhojnë situatën e sigurisë në vend.

Kryeministri malazez vjen sot në Kosovë

Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq, sot (e mërkurë) do të vijë për një vizitë dyditore në Kosovë. Fillimisht kryeministri Markoviq do të pritë me nderime shtetërore nga homologu Ramush Haradinaj. Pas takimit të përbashkët ata do të mbajnë një konferencë për medie. Ndërsa në ditën e dytë të vizitës, Markoviqi do të pritë në takime të ndara nga presidenti dhe kryeparlamentari

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 SHKURT - Shefi i Qeverisë së Malit të Zi, Dushko Markoviq, sot (e mërkurë) viziton Republikën e Kosovës. Konfirmimin për ardhjen e kryeministrit malazez në vendin tonë e ka bërë me dije kryeministri Ramush Haradinaj të martën në mbledhjen e kabinetit qeveritar.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se vizita e homologut të tij në prag të shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë është nder për shtetin e Kosovës. Ai ka kërkuar nga vartësit e tij që t'i marrin përgjegjësit e nevojshme me përvjetorin jubilar të shtetësisë. "Ardhja e kryeministrit të Malit të Zi është nder që i bën Kosovës. Ne tani po hyjmë në javën e aktiviteteve të shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë së vendit tonë, prandaj kërkoj nga të gjithë ministrat që ta marrin përgjegjësinë dhe ta ndajnë kohën për pritjen e zyrtarëve që vijnë në Kosovë, në mënyrë që të jemi bashkë dhe të dëshmojmë se kjo është një ngjarje e rëndësishme", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Kryeministri i Republikës së Malit të Zi, Dushko Markoviq, do të vijë në orën 16:00 në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari". Ai do të pritë në aeroport nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinosha dhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Malin e Zi, Skender

Durmishi. Më pas, kryeministrit malazez i është rezervuar pritja me nderime shtetërore nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Pas takimit është paraparë të mbahet një konferencë e përbashkët e dy kryeministrave.

Ndërsa në ditën e dytë të vizitës së tij në Kosovë, kryeministri i Malit të Zi do të pritë në takime të ndara nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.

Vizita e kryeministrit të Malit të Zi, Dushko Markoviq, është mirëpritur dhe është vlerësuar pozitivisht nga liderët shtetërorë dhe analistët politikë. Sipas tyre, ardhja e Markoviqit mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjes së demarkacionit në mes të dy vendeve. Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka uruar që vizita e kryeministrit malazez të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore. Ai ka shprehur optimizëm se kjo vizitë mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. "Besoj se do të mund të kontribuojë sepse, në ndërkohë, edhe në koalicionin aktual qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi dhe ka pasur edhe kontakte me Podgoricën që të gjendet një zgjidhje që Qeverinë aktuale dhe Haradinajn e nxjerrin 'faqebardhë'. Vizita e kryeministrit Markoviq uroj të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore me Malin e Zi", ka deklaruar Maliqi për gazetën "Epoka e re".



Sali Bislimi: PLK-ja do të angazhohet që Kosova të integrohet në BE

Përfaqësuesi i Partisë Liberale të Kosovës (PLK) për diasporë, Sali Bislimi, ka thënë se ky subjekt politik do të angazhohet që Kosova të integrohet në strukturat e Bashkimit Evropian. Ai ka theksuar se BE-ja është i vetmi vend që i bashkon shqiptarët

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Partia Liberale e Kosovës (PLK) ka shënuar të martën 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës në një takim me kryesinë, këshillin kombëtar dhe kryetarët e degëve.

Sali Bislimi, përfaqësuesi i PLK-së për diasporë, ka thënë se ky subjekt politik me rastin e dhjetëvjetorit të shtetësisë nderon gjithë dëshmorët e kombit. Ai ka thënë se PLK-ja nuk do të lejojë që fatin e Kosovës ta drejtojnë era, por do të angazhohet në të gjitha format që Kosova të integrohet në vlerat euroliberale. "Ky destinacion është i vetmi objektiv që i bashkon shqiptarët", ka thënë Bislimi. Ai ka

theksuar se në PLK duhet të bëhen reforma në mënyrë që zëri i liberalëve të dëgjohet në çdo qytet të Kosovës.

Bislimi ka pohuar se PLK-ja është një parti e cila në vazhdimësi ka dhënë kontributin e saj në proceset integruese për Kosovën. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe lideri i kësaj partie, njëherësh zëvendësiministër i Punëve të Jashtme, Gjergj Dedaj, i cili ka folur për ecurinë dhe zhvillimin e PLK-së. Dedaj ka paralajmëruar se PLK-ja veçse po fuqizohet në skenën politike, si dhe ka bërë me dije se kongresi i tetë i kësaj partie do të mbahet më 27 tetor të këtij viti.



Veseli ia dhuron flamurin e Republikës së Kosovës veprimtarit Adem Demaçi

PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në prag të dhjetëvjetorit të pavarësisë së Kosovës, ka vizituar veprimtarin e çështjes kombëtare, Adem Demaçin. Ai ka thënë se askush më shumë prej të gjallëve sesa Adem Demaçi nuk bart mbi supë sakrificën në rrugën për liri dhe pavarësi. "Një pjesë e historisë së Kosovës është historia e jetës së tij. Një takim emocional me bacën Adem, në konakun e tij, për ta falënderuar dhe për t'ia uruar 10-vjetorin e pavarësisë", ka thënë kryeparlamentari Veseli.



'Kadri Zeka' dhe komuna e Kamenicës nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

GJILAN, 13 SHKURT (ER) - Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan, Bajram Kosumi, me bashkëpunëtorë, kanë qëndruar të martën në Komunën e Kamenicës, ku janë pritur nga kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati.

Rektori Kosumi fillimisht e ka uruar kryetarin Kastrati për marrjen e detyrës së re kryetar komune, kurse e ka njoftuar rreth zhvillimit dhe funksionimit të universitetit. Rektori Kosumi ka thënë se Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" do të krijojë kuadro të përgatitur për tregun e punës, respektivisht kuadro për arsim, ekonomi, administratë si dhe për fushat e tjera përmes të cilave Kosova, por edhe rajoni, do të rrisin aftësitë konkurruese në nivelin arsimor dhe aspektet e tjera.

Kurse kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, e



ka falënderuar rektorin Bajram Kosumi për urimin, njëherësh e ka siguruar se Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" do ta ketë mbështetjen e Komunës së Kamenicës. Me këtë rast, rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan, Bajram Kosumi dhe kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për nxitjen e

shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional. Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët, përkrahjen e studentëve gjatë studimeve dhe identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në zhvillimin e gjithëmbarshtëm socio-ekonomik të rajonit ekonomik të dy institucioneve.

Veseli premtton ngritjen e një memoriali për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të martën në një takim përfaqësuesit e katër organizatave të shoqërisë civile, të licencuara për ta bërë verifikimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Qendrën për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT, Medika Kosova, Medika Gjakova dhe Qendrën për Promovimin e Gruas në Drenas.

Veseli u informua rreth procesit të verifikimit për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës, ndërsa u falënderua për mbështetjen e dhënë në vazhdimësi për këtë kategori, në aspektin legjislativ dhe atë financiar.

Kryeparlamentari Veseli ka falënderuar përfaqësueset e



këtyre organizatave për punën e tyre të bërë deri më tash. Ai ka premtuar se gjatë këtij viti përballë Kuvendit të Republikës Kosovës do të ngrihet një memorial për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës. Në këtë takim është diskutuar edhe mundësia që kjo kategori të përfitojë shërbime shëndetësore falas.

Veseli, po ashtu, ka premtuar se do të trajtohen me prioritet problemet e shfaqura në zbatim të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Presidenti i Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, ka mbajtur fjalim para deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Pahori kërkon nga Kosova ta ratifikojë demarkacionin



Presidenti i Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, u është drejtuar të martën me një fjalim deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ai i ka inkurajuar deputetët ta zgjidhin problemin e kufirit me Malin e Zi në mënyrë që Kosova të bëhet pjesë e BE-së. Po ashtu, ai ka thënë se i mbështet përpjekjet e Kosovës dhe të Serbisë që t'i zgjidhin problemet e hapura përmes negociatave të mbështetura nga BE-ja

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Për nder të presidentit të Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën një seancë solemne. Para seancës, presidenti slloven është pritur në një takim të veçantë nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

Presidenti Pahor, nën duartrokitjet e deputetëve, hyri në sallë i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Kryetar Veseli para deputetëve ka theksuar se vizita e presidentit Pahor në Kosovë është dëshmi e partneritetit dhe miqësisë që është ndërtuar në mes dy shteteve tona. "Sllovenia në vazhdimësi ka qenë përkrah

Kosovës në të gjitha proceset e saj historike. Duke pasur këtë mbështetje, sot Kosova ndihet më e sigurt dhe më e fuqishme në rrugën euroatlantike", ka thënë Veseli. Ai ka pohuar se adresimi i presidentit slloven Borut Pahor në Kuvendin e Kosovës shpreh më së miri frymën e partneritetit dhe bashkëpunimit mes dy vendeve. Më pas, për t'i përshëndetur deputetët me një fjalë rasti kryetari i Kuvendit ia kaloi fjalën presidentit Pahor. Në fjalën e tij, presidenti Pahor ka thënë se ashtu sikurse sllovenët, edhe kosovarët e kanë themeluar shtetin e pavarur. "Në këtë aspekt kam ardhur në Kosovë si një mik i shqiptarëve të Kosovës, i serbëve dhe si një mik i të gjitha etnive të tjera që jetojnë në Kosovë. Është tejet e rëndë-

sishme për zhvillimin e Kosovës t'i ruajë dhe fuqizojë të drejtat e komuniteteve. Pavarësisht prej problemeve, duhet t'i përmirësojë marrëdhëniet me fqinjët", ka deklaruar Pahori.

Ai ka thënë se i mbështet përpjekjet e Kosovës dhe të Serbisë që t'i zgjidhin problemet e hapura përmes negociatave të mbështetura nga BE-ja. "Është e rëndësishme që të zgjidhen problemet dhe të thellohet bashkëpunimi i përgjithshëm. Po i jap vetes të drejtë t'ju them, vazhdojeni dialogun, jo vetëm për zgjidhjen e problemeve të dy vendeve, por edhe për krijimin e një klime të mirë për tërë rajonin, në mënyrë që të bindet BE-ja që edhe këto vende duhet të jenë pjesë e saj. Unë në përgjithësi e mbështes strategjinë e BE-së për zgjerimin me vendet e Ballkanit perëndimor", është shprehur presidenti Pahor.

Ai i ka inkurajuar deputetët ta zgjedhin problemin e kufirit me Malin e Zi në mënyrë që Kosova të bëhet pjesë e BE-së. "Ju inkurajoj të mos hezitoni ta miratoni marrëveshjen për demarkacionin. E di sa është e vështirë, por nuk ka mënyrë tjetër. Si mik ju inkurajoj të mos hezitoni ta

zgjidhni këtë çështje. Duhet të keni guxim politik, i cili do t'ju çojë drejt BE-së dhe NATO-s. Dhe për këtë Sllovenia do t'ju ndihmojë. Përgjegjësi e BE-së është të na i hapë dyert, mirëpo ne jemi përgjegjës për krijimin e

bashkëpunimit. Është një detyrë e vështirë, por në fund njerëzit tanë shpërblehen. Vendet e rajonit duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të arrihet një e ardhme më e mirë", ka thënë Pahori.

Pahori takohet me përfaqësues të LDK-së dhe Vetëvendosjes

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, të martën ka takuar deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të prirë nga shefi i grupit parlamentar Avdullah Hoti. Në këtë takim është biseduar për rolin e Sllovenisë si shtet mik i Kosovës dhe për të arriturat si dhe sfidat e vendit tonë në prag të shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës.

Presidenti Pahor ka vlerësuar lart kontributin e Lidhjes Demokratike të Kosovës në shtetndërtimin e vendit dhe konsistencën e vazhdueshme në përkushtimin për integrimet euroatlantike. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, e ka cilësuar tepër të

çmueshme mbështetjen e Sllovenisë në përpjekjet e Kosovës për zhvillim ekonomik dhe anëtarësim në organizmat e rëndësishëm ndërkombëtarë.

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, është takuar edhe me udhëheqjen e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas një njoftimi të IV-së, në këtë takim është biseduar për situatën politike dhe ekonomike në vend, të arriturat e shtetit të ri të Kosovës në vigjilje të 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, si dhe fushat në të cilat Kosova ka nevojë t'i koncentrojë përpjekjet për zhvillim. Presidenti slloven ka takuar edhe përfaqësuesit e partive të pakicave që janë pjesë e Kuvendit të Kosovës.

SBASHK-u kërkon nga nxënësit ta bojkotojnë orën e parë të mësimit

PRISHTINË, 13 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) u ka bërë apel prindërve dhe nxënësve që në kohë grevash mos të nisen për në shkollë. SBASHK-u ka kërkuar që sot (e mërkurë) nxënësit të mos jenë në

shkollë në orën e parë në të dy ndërrimet. SBASHK-u ka bërë me dije se kjo grevë do të mbahet për shkak të mosrealizimit të kërkesave nga ana e Qeverisë. "Ata le të jenë në vatrat e tyre të diturisë në kohën e duhur për ta nisur orën e dytë. Nëse gjendja

nuk ndryshon, atëherë ju lusim që edhe të martën, më 20 shkurt, nxënësit mos të jenë në shkollë në dy orët e para të dy ndërrimeve, por të shkojnë me kohë për ta nisur mësimin në orën e tretë", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.



Ministri Hasani promovon turizmin e Kosovës para ministrave të vendeve të BE-së

SOFJE, 13 SHKURT (ER) - "Turizmi është një segment shumë i rëndësishëm për Kosovën. Promovimi i produkteve, shërbimeve, prezantimi i përvojave dhe aktiviteteve të ndryshme, me qëllim që t'i nxisin vizitorët për t'i përjetuar bukuritë e Kosovës, është qëllimi primar i MTI-së që reflekton edhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik", kështu ka thënë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, në konferencën "Turizmi dhe zhvillimi ekonomik" që po mbahet në Sofje të Bullgarisë, ku po marrin pjesë ministrat e shumë vendeve të Bashkimit Evropian (BE).

Ministri Hasani ka thënë se Kosova ofron mundësi të favorshme për zhvillimin e turizmit gjatë katër stinëve të vitit.

"Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duke njohur rëndësinë e turizmit dhe kontributin në zhvillimin ekonomik të Kosovës, është e përkushtuar ta zhvillojë një turizëm të qëndrueshëm dhe konkurrues", ka shtuar i pari i Ministrisë së Tregtisë.

Ministri Hasani është shprehur se përmirësimi i infrastrukturës rrugore, autostradës dhe ndërtimi i aeroportit të ri modern do t'u mundësojnë turistëve qasje më të lehtë dhe lidhje me destinacionet e Kosovës. Sipas tij, kjo do të shërbejë edhe si arterie për arritjen në vendet e tjera në rajon.

Duke prezantuar bukuritë e Kosovës, ministri Hasani është shprehur se Kosova, edhe pse një vend i vogël, ka potenciale turistike mjaft të mira natyrore dhe kulturore, por është ende



vend i pazbuluar për shumicën e turistëve ndërkombëtarë.

Hasani para ministrave të turizmit të shumë vendeve të BE-së ka treguar se shtyllat kryesore prior-

itare të turizmit në Kosovë janë turizmi kulturor, turizmi malor dhe alpinist, turizmi rural, turizmi ekologjik dhe alternativ, turizmi aktiv, udhëtimet ndërkufitare.

Ministri Hasani ka prezantuar edhe gastronominë e Kosovës duke thënë se kuzhina shqiptare është vlerësuar lart nga turistët ndërkombëtarë.

OAEK-u: Të punohet më shumë që të rriten përfitimet e Kosovës nga CEFTA

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Pavarësisht prej të mirave që Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) i ka sjellë Kosovës në aspekt të integritimit në tregun rajonal, përfitimet në aspektin ekonomik nga kjo marrëveshje kanë qenë të vogla, marrë parasysh sfidat e shumta me të cilat janë ballafaquar prodhuesit vendorë gjatë viteve. Ky ishte konkluzioni kryesor në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OAEK) me titull "CEFTA: Tregti e lirë, por sa e drejtë?"

Menaxheri i politikave në Odën Amerikane, Visar Hapçiu, ka theksuar se në kohën kur



Kosova është bërë anëtare e kësaj marrëveshjeje, vendi është përfaqësuar përmes Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, gjë që i ka pamundësuar vendosjen e masave për mbrojtjen e prodhimitarisë vendore, ngjashëm si vendet e tjera anëtare të mar-

rëveshjes. Ai ka thënë se kur kësaj i shtohen edhe politikat jo shumë të favorshme fiskale që kanë qenë në fuqi për prodhues, kjo ka rezultuar që përfitimet nga CEFTA për shtetin e Kosovës të mos jenë shumë të mëdha.

Drejtoresha e Departamentit të

Tregtisë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Sytrime Dervisholli, vuri theksin në një numër të barrierave që shtetet e tjera anëtare të marrëveshjes kanë aplikuar për produktet e Kosovës përgjatë viteve sa kjo marrëveshje është në fuqi. Ajo ka sqaruar se MTI-ja në vazhdimësi ka adresuar këto sfida në sekretariat të CEFTA-s, por reagimi nga palët homologe nuk ka qenë gjithmonë ai i duhuri. Po ashtu, Dervisholli vuri theksin edhe mbi legjislacionin ekzistues për masat mbrojtëse në importe, duke sqaruar se MTI-ja ka ndërtuar kapacitetet që të zbatojë këto ligje.

Ndërkaq kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Valdet Gjinovci, ka thënë se është për keqardhje që prod-

huesit kosovarë janë ballafaquar me barrierat e shumta jotarifore në eksportet e tyre në vende anëtare të CEFTA-s.

Hakif Gashi, përfaqësues i kompanisë "Meridian Corporation", njëherësh zëvendës-president i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, ka pohuar se CEFTA në mesin e komunitetit të biznesit më shumë është vlerësuar për nga pesha politike sesa ekonomike. Ai ka theksuar se institucionet e vendit duhet të punojnë me sektorin privat në përgjithësi dhe sektorin e prodhimit në veçanti.

Përfaqësuesi i ndërmarrjes prodhuese "Scampa", Kujtim Gjevori, ka theksuar se deri më tani CEFTA nuk ka qenë favorizuese për Kosovën.

Autostrada Prishtinë - Gjilan do të kushtojë 88 milionë euro

PRISHTINË, 13 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj dhe zëvendësministri Rexhep Kadriu, kanë mbajtur të martën një konferencë me gazetarë lidhur me nënshkrimin e kontratave të operatorëve për ndërtimin e autostradës A 7.1 Prishtinë - Gjilan.

Ministri Lekaj ka thënë se nënshkrimi i kontratës për këtë projekt është lajm i mirë për të gjithë qytetarët e Anamoravës ngaqë kjo autostradë lidhë Gjilanin me pjesët e tjera të

Kosovës. Lekaj, duke folur për këtë projekt, ka thënë se autostrada do të kushtojë 88 milionë euro dhe do të jetë në një gjatësi prej 22.3 kilometrash. Ai ka bërë me dije se punimet pritet të fillojnë në pranverë të këtij viti dhe do të zgjasin 30 muaj. Ndërkaq zëvendësministri i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, duke folur për rëndësinë e kësaj autostrade, ka treguar se autostrada do t'i ketë tri kycje, duke filluar me atë të Banullës, pastaj një në Zhegovc dhe e fundit do të jetë në Bresalc.



Mbahen Panairi i Prodhimeve Vendore dhe Forumi Ekonomik "10-vjetori i pavarësisë ekonomike të Kosovës"

Thaçi: Tregu ynë duhet të mbushet me prodhime 'Made in Kosova'



Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se prodhuesit vendorë janë ballafaquar me sfida të panumërta, por asnjëherë nuk janë dorëzuar, kanë mbijetuar dhe janë zhvilluar. Ai ka bërë thirrje që tregu ynë të mbushet me prodhime "Made in Kosova"

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka marrë pjesë në Panairin e Prodhimeve Vendore dhe Forumin Ekonomik "10-vjetori i pavarësisë ekonomike të Kosovës", të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës. Thaçi ka thënë se janë mbledhur në një moment të veçantë, në prag të 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. "Në këto momente duhet të kujtojmë se ku kemi qenë dhe ku jemi sot, por edhe ku aspirojmë të arrijmë. I kujtojmë vuajtjet dhe shkatërrimet e luftës. Por, e kujtojmë edhe vendosmërinë tonë për t'u mos u dorëzuar, për t'u ringritur, për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar", ka thënë presidenti Thaçi. Për prodhuesit vendorë, presidenti Thaçi ka thënë se janë ballafaquar me sfida të

panumërta, por asnjëherë nuk janë dorëzuar, kanë mbijetuar dhe janë zhvilluar. "Sot, zhvillimi i Kosovës, sukseset e dekadës sonë të parë, lidhen ngushtë me ju", ka thënë Thaçi. Kreu i vendit ka shtuar se në dekadën e parë shteti ynë ka shënuar hapa të rëndësishëm për konsolidimin e shtetësisë si në rrafshin kombëtar, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. "Kemi nënshkruar MSA-në me Bashkimin Evropian dhe jemi ftuar nga NATO-ja për bashkëpunim të avancuar. Këta dy hapa kanë qenë shumë të rëndësishëm për të ardhmen tonë dhe na kanë vënë fuqishëm në binarë drejt anëtarësisë në NATO dhe BE", ka pohuar presidenti Thaçi. Ai ka thënë se Kosova ka vazhduar ta promovojë dialogun brenda vendit dhe në marrëdhënie me fqinjët tanë, duke u bërë eksportuese e paqes dhe kontribuuese e stabilitetit dhe

prosperitetit rajonal. "Kosova, po ashtu, shënoi të arritura të mëdha në skenën ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës e sportit", ka theksuar i pari i vendit, duke shtuar se "sukseset dhe arritjet tona janë rezultat edhe i bashkëpunimit të fuqishëm me partnerët tanë". Presidenti Thaçi ka shtuar se bashkë kanë punuar të ndërtojnë një platformë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenie qytetare, duke përfshirë të gjitha kërkesat e komunitetit të biznesit. "I bëmë 10 vjet si shtet dhe është koha që shteti, tregu ynë, të mbushet me prodhime 'Made in Kosova'", ka theksuar Thaçi. Ai ka thënë se duhet të jemi krenarë me të arriturat e Kosovës dhe me të arriturat e deritashme të prodhuesve. Në këtë organizim ka marrë pjesë edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e cila ka theksuar se 17

shkurti i vitit 2008 shënoi një pikë kthese në historinë bashkëkohore të vendit tonë, duke kujtuar sakrificën dhe luftën që bëri populli ynë për ta arritur 17 shkurtin e 2008. Ajo ka thënë se nuk duhen harruar ata që ndihmuan dhe kontribuan që Kosova të bëjë këtë kthesë historike dhe të jetë shtet i pavarur. "Ndryshimet janë të evidente dhe të pamohueshme qoftë në zhvillimin e sektorit privat, në sektorin bankar, në eksport, sidomos në infrastrukturën rrugore në zhvillimin urban dhe zhvillimin rural", ka deklaruar Hoxha, duke shtuar se pjesë shumë e rëndësishme e këtij progresi është nënshkrimi i MSA-së, marrëdhënies së parë kontraktuale me Bashkimin Evropian. "Zbatimi i përpiktë i MSA-së do të thotë progres jo vetëm në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe në të gjitha fushat e tjera. Ne e kemi udhërrëfyesin se cila është rruga jonë e reformave dhe ajo është MSA-ja. Neve na mbetet vetëm të punojmë për t'i përmbushur obligimet që dalin nga ajo", është shprehur ministrja Hoxha.

Ajo ka përmendur edhe sfidat siç është e drejta e lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Evropian. Hoxha ka theksuar se bizneset, qytetarët, afaristët e studentët privohen nga mundësia e zhvillimit qoftë të biznesit apo të punëve të tjera në vendet e BE-së në mungesë të liberalizimit të vizave dhe kjo ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit. Ndërkaq ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, para pjesëmarrësve të kësaj konference ka thënë se Kosova në 10 vjetet e fundit nuk ka arritur ta krijojë identitetin e vet, duke ftuar bizneset që bashkërisht me institucionet të krijojnë identiteti ekonomik i Kosovës. Beqaj ka folur edhe për rëndësinë e themelimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë duke thënë se përmes kësaj ministrie rina ta kapë hapin me botën në fushën e teknologjisë. Në hapësirat ku është mbajtur konferenca e organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës janë prezantuar disa prej produkteve të prodhuesve të suksesshëm kosovarë.

Ministri Berisha njofton kryetarët e komunave me të arriturat e FSK-së

JUNIK, 13 SHKURT (ER) - Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rustem Berisha, së bashku me gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj, drejtor i Departamentit të Operativës dhe Trajnimeve, si dhe Shpëtim Selmanaj këshilltar i ministrit, realizuan vizita zyrtare në komunat Klinë, Deçan dhe Junik. Ministri Berisha, gjatë vizitës së tij në këto komuna, u prit nga kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj dhe kryetari i Junikut, Agron Kuçi. Ministri Berisha gjatë

takimeve që zhvilloi me kryetarët e këtyre tri komunave, i njoftoi ata me arritjet e FSK-së, sukseset individuale dhe të përgjithshme, shkollimet dhe trajnimet si brenda ashtu edhe jashtë vendit, bashkëpunimin me NATO-n, transformimin e FSK-së, si dhe realizimin e shumë projekteve humanitare të FSK-së në shërbim të komuniteteve joshumicë dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Vizita e ministrit Berisha dhe delegacionit që ai drejtonte kishte për qëllim vlerësimin e mundësive të bashkëpunimit

të FSK-së me këto komuna, ku në rast nevojë të mund t'u ofronte ndihmë përmes Departamentit për Bashkëpunim Civil-Ushtarak, për realizimin e projekteve të ndryshme bazuar në kapacitet që ka FSK-ja.

Ndërkaq kryetarët Elezaj, Ramosaj dhe Kuçi e kanë falënderuar ministrin Berisha për vizitën, njëherësh e kanë njoftuar me aktivitetet komunale, për realizimin e kërkesave të qytetarëve, duke theksuar problemet kryesore me të cilat përballen qytetarët e këtyre komunave.



Përkujtohet dëshmori Avni Hajredini

MITROVICË, 13 SHKURT (ER) - Në 18-vjetorin e rënies në mbrojtje të shqiptarëve në "Lagjen e Boshnjakëve" që ishin sulmuar barbarisht nga bandat kriminale serbe në shtëpitë dhe pronat e tyre, është përkujtuar dhe martën dëshmori i kombit Avni Hajredini.

Në pllakën përkujtimore ku është vuar nga ushtarët francezë të KFOR-it, në veri të lumit Ibër në "Lagjen e Boshnjakëve" dhe tek Varrezat e Dëshmorëve në Shipol, kanë bërë homazhe familjarë të

dëshmorit, nënkryetari i komunës Faruk Mujka, drejtorët komunalë, përfaqësues të lagjes dhe qytetarë të tjerë.

Nënkryetari Mujka, duke folur për këtë figurë emblematike të luftës për çlirimin e vendit dhe vendosmërisë e përkushtimit për t'i mbrojtur edhe pas përfundimit të luftës shqiptarët e pjesës veriore të Mitrovicës nga sulmet e vazhdueshme të bandave serbe, ka thënë se dëshmori Hajredini ishte një nga luftëtarët më trim dhe më i vendosur për ta mbro-

jtur vendin.

Për kontributin e dëshmorit Avni Hajredini për çështjen kombëtare dhe për çlirimin e vendit e të Mitrovicës, folën edhe familjarët e tij.

Dëshmori Hajredini ishte vuar më 13 shkurt të vitit 2000 në "Lagjen e Boshnjakëve" në veri të qytetit të Mitrovicës, kur po kalonte nëpër lumin për të dalë në veri në mbrojtje të shqiptarëve që ishin sulmuar barbarisht nga bandat kriminale serbe.

Naim Ismajli kompletion kabinetin qeverisës



SHTIME, 13 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka emëruar drejtorët e rinj të drejtorive komunale. Muhadin Halili është emëruar drejtor i Administratës së Përgjithshme, Mensur Neziraj drejtor për Arsim, Shqipe Rexhaj drejtoreshë për Planifikim Urban, Kadastër dhe

Gjeodezi, Fitim Hoxha drejtor për Zhvillim Ekonomik. Lumni Amrushaj drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Halil Halili drejtor për Shërbime Publike dhe Shpresa Tafa drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Drejtorët e rinj pritet ta fillojnë punën nga 1 marsi i këtij viti.

Nismës i bashkohen dy figura kryesore të Vetëvendosjes në Ferizaj

FERIZAJ, 13 SHKURT (ER) - Nismës Socialdemokrate i janë bashkuar edhe dy anëtarë të rinj: sekretari i Degës së Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, Fazli Shabani dhe sekretari për media i LV-së në Ferizaj, Naim Berisha. "Shabani dhe Berisha tani e tutje angazhimin e tyre politik do ta zhvillojnë në Nismën Socialdemokrate, të cilët u shprehën të kënaqur që po i bashkohen subjektit politik Nisma", është thënë në njof-

timin për medie të Nismës Socialdemokrate.

Kryetari i Degës së Nismës në Ferizaj, Besnik Berisha, u ka uruar mirëseardhje dy anëtarëve të rinj dhe i ka falënderuar për rreshtimin e tyre në Nisma. Në prezantimin e dy anëtarëve të rinj ishin edhe anëtarët e Kryesisë Qendrore të Nismës, Haxhi Shala dhe Çerkin Dukolli, të cilët uruan Shabanin dhe Berishën për rreshtimin e tyre në Nisma.



Në Deçan një personi i vidhen 7 500 euro

DEÇAN, 13 SHKURT - Policia e Kosovës ka bërë me dije se në fshatin Carrabreg i Epërm të Deçanit një person ka raportuar se persona të panjohur kanë hyrë në shtëpinë e tij dhe kanë vjedhur një shumë të parave dhe një sasi ari në vlerë të përgjithshme rreth 7 500 euro.



Njësitë policore janë duke hetuar rastin.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (5)

ADEM DEMAÇI, I BURGOSURI POLITIK MË I FAMSHËM NDËR SHQIPTARËT



Selatin NOVOSELLA

82. Fehmi Berisha, veprimtar i çështjes kombëtare: Për Adem Demaçin dashuria dhe ndërgjegjia njerëzore duhet të ngadhënjë Adem Demaçi, duke e njohur thellësisht mendësinë dhe shpirtin e popullit shqiptar, dhe përkundër që ndaj tij, të ligët dhe injorantët, bënë edhe shtab që paseshtur do të merrej me fyerjen, ofendimin, denigrimin dhe anatemimin e tij, ai, sërish, "vetëm buzëqeshi", i bindur se vetëm dashuria është ndërgjegje njerëzore dhe se vetëm dija duhet të fitojë mbi injorancën, qoftë edhe duke u flijuar e rënë theror.

83. Feride Papeka, shkrimtare: Filozofia jetësore e Adem Demaçit - jeta duhet ta mund vdekjen Duke lexuar romanin e Adem Demaçit "Gjarpinjtë e gjakut", një ide e fuqishme vjen dhe shuan kufijtë kohor për t'u shndërruar në një filozofi të vetme universal: Jeta duhet ta mund vdekjen. Vepra të tilla e humanizojnë botën, i japin formën e dëshirave sublime, në të cilat duhet të triumfojë e Mira dhe e Bukura.

84. Ferit B. Dibrani, publicist: Adem Demaçi, armiku numër një në Jugosllavi

Duke vërejtur se Adem Demaçin, pas lirit nga burgu i dytë, në vitin 1974, po e vizitonin shumë qytetarë, se ai tashmë ishte shndërruar në lider shpirtëror të shqiptarëve të robëruar, UDB-ja dhe Lidhja e Komunistëve mori vendim që Demaçi të burgosej përsëri, sepse për pushtuesin ai ishte armiku numër një në Jugosllavi.

85. Filla Fillota, avokat: Adem Demaçi deklaroi se "s'ka paqe në Jugosllavi pa u bashkuar Kosova me Shqipërinë"

Në vitin 1964 e kam mbrojtur një të burgosur, Nijaza Saraçogllja, që po gjykohej së bashku me Adem Demaçin dhe shumë të tjerë. Demaçi, në fjalën përfundimtare para gjyqit, përveç tjerash, tha: "Pa u bashkuar Kosova dhe territoret tjera shqiptare të banuara me shqiptarë në Jugosllavi me Shqipërinë, s'do të ketë paqe as në Jugosllavi as në rajon".

86. Flora Brovina, kryetare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës: Adem Demaçi, klasik i letërsisë moderne Flijimi i tij e ka bërë Adem Demaçin simbol të lirisë dhe pavarësisë kombëtare. Ai edhe sot është ndër klasikët e letërsisë sonë moderne. Personaliteti veprimtar dhe krijues i zotit Adem Demaçi, deri sot, është nderuar me shumë çmime dhe mirënjohje kombëtare dhe ndërkombëtare.

87. Florim Berisha, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, vetëm 10-vjeçar, e pyeste mësuesen serbe: "pse nxënësit serbë nuk mësojnë shqip siç mësojnë ne shqiptarët serbisht?!"

Adem Demaçi si nxënës i klasës së parë Gjimnaz në Prishtinë, vetëm dhjetë vjeçar, në vitin 1946, arsimitares serbe ia bëri pyetjen: "Pse edhe nxënësit serbë nuk mësojnë shqip sikurse shqiptarët që mësojnë serbisht?!" Ajo u zhgreh në vaj dhe e lëshoi orën e mësimi, duke bërë ankesë te drejtori i shkollës.

88. Frashër Demaj, historian: Adem Demaçi të zgjedhet kryeministër i Kosovës

S'do të kisha asgjë kundër zgjedhjes së Adem Demaçit në krye të Kuvendit të Kosovës, mirëpo mendoj se më e rëndësishme është që të riformatohet Qeveria e Kosovës dhe Demaçi të jetë kryeministër ose ministër i punëve të jashtme, pasi që është i njohur në botë dhe është fitues i çmimeve ndërkombëtare.

89. Gani Krasniqi, kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës: Adem Demaçi ishte në ballë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës po i binte orës së madhe të lirisë, Baca Adem Demaçi, ishte në ballë saj për të bërë mësimin e madh të historisë se pa luftë të armatosur nuk ka Liri dhe Atdhe.

90. Gazmend Kajtazi, gazetar: Adem Demaçi ka mbetur i pathyeshëm dhe i papërkulur përballë hegjemonizmit serb

Adem Demaçi është shqiptari të cilin më së shumti e ka mbajtur në burg Serbia. Por, Adem Demaçi ka mbetur i pathyeshëm, i papërkulur dhe i pa dorëzuar përballë hegjemonizmit serb. Ai burgun e konsideron si një përvojë të madhe, përfshirë edhe pesë vitet e kaluara në vetmi të plotë. Ndonëse i ka kaluar 28 vjet në burgje, ai gjen forcë ta "falënderojë" Serbinë, "...që e futi nëpër këto kanale të luftës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës".

91. Gjekë Gjonlekaj, Adem Demaçi, simbol i qëndresës

Gazetarët amerikanë kishin të dhëna për Adem Demaçin. Kohë pas kohe ata njoftonin për dënimin dhe vuajtjet e këtij intelektualit disident. Komentet dhe korrespondencat e gazetarëve amerikanë zgjonin kurajën dhe interesimin e shqiptarëve të Amerikës. Pas një kohe relativisht të shkurtër Adem Demaçi u shndërrua në simbol të qëndresës.

92. Gjuro Perica, bashkëvuajtës gjatë 14 viteve, i Adem Demaçit në Burgun e Stara Gradishkës: Adem Demaçi ishte inspirim për mua në burg

Adem Demaçi është njeri i cili edhe për mua personalisht ishte inspirim që ta përballoja burgun tim. Sepse, jeta e tij pak karizmatike në përcaktimin dhe bindjen e tij se

lufton për çështje të drejtë më ka dhënë forcë që edhe unë të qëndroj në bindjen time.

93. Hajdin Abazi, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaç, Sali Berisha dhe Ismail Kadare kishin një akord

Kthesat filluan me Adem Demaçin, në një intervistë njëorëshe në programin satelitor të TVSH-së. Pastaj, presidenti Sali Berisha dhe Ismail Kadare. Që të tre, sa i përket perspektives së lëvizjes demokratike shqiptare të Kosovës, kishin një akord.

94. Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës: Adem Demaçi eci para kohës

Baca Adem Demaçi, eci para kohës. Ai fillonte qëndresën për t'u bërë motiv për formësimin të vetëdijes kombëtare. Nuk ka emër



të përveçëm dhe të gjallë në historinë tonë të re si komb që ishte dhe është më frymëzues se Baca Adem.

95. Haki Kasumi, historian: Ukshin Hoti pasues besnik i rrugës së Adem Demaçit

Adem Demaçi ishte dhe mbeti veprimtari i parë dhe i pathyeshëm i idealeve të pastra kombëtare shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit njëzet, ndërsa Ukshin Hoti, me plotë të drejtë, duhet të konsiderohet si pasues besnik i rrugës së drejtë, idealit kombëtar, i qëndrimit dinjitoz dhe si hartues e begatues i platformës dhe strategjisë moderne politike të luftës çlirimtare shqiptare.

96. Hakif Bajrami, historian: Adem Demaçi, njëri prej liderëve më të mëdhenj shqiptar të shek XX

Adem Demaçi është njëri ndër liderët më të mëdhenj shqiptar të shekullit XX. Vepra e tij është kryqëzata më fitimtare dhe më dinjitoze e luftës dhe e sakrificës, është simboli më sublim i daljes së shqiptarëve nga inferioriteti, është zëri i ndërgjegjes së një populli, është amaneti i Hasan Prishtinës e Bajram Currit në vazhdim, është mësues i gjeneratës së Fehmi Lladrovit.

97. Hail Katana, gjeneral i Ushtrisë së Shqipërisë: Adem Demaçi luajti një rol të rëndësishëm në afirmimin e UÇK-së

Adem Demaçi la udhëheqjen e Partisë Parlamentare të Kosovës dhe pranoi detyrën tepër të rëndësishme të përfaqësimit Politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai, me personalitetin e tij të madh, i njohur nga bota, luajti një rol shumë të rëndësishëm në afirmimin e UÇK-së si ushtri çlirimtare, deri te njohja e saj dhe vendosjen në ballin e nderit në Rambuje.

98. Halil Matoshi, publicist: Adem Demaçi është kreator i idesë së kryengritjes së Kosovës

Adem Demaçi është kreator i idesë së kryengritjes së Kosovës kundër pushtetit jugosllav dhe këso dore njeri i sakrificës dhe lirisë. Libri "Adem Demaçi - Biografi" i Shkëlzen Gashit mund të cilësohet edhe si histori e shkurtër e Kosovës, histori politike, diplomatike, ushtarake madje edhe shtetformuese.

99. Hamdi Thaçi, historian: Adem Demaçi, Feniksi shqiptar

Me Adem Demaçin u ringjall Feniksi Shqiptar. Ai po shpërthente si ylber me shumë ngjyra duke sinjalizuar, kështu, një filozofi të qëndrueshmërisë e të stoicizmit që simbolizonte rezistencën shekullore të përmbledhur në një sfidë: "ku i vogli shtrinë viganin...veç tok, tok ore marathonomk!"

100. Hanëmshaha Ilazi, publiciste: Adem Demaçi ishte mbështetje shpirtërore për të rinjtë lirisdashës

Edhe pse Adem Demaçi nuk ishte fizikisht i pranishëm gjatë punës përgatitore për organizimin e demonstratave të vitit 1968, ai ishte shpirti frymëzues për të gjithë ata që u morën me këtë veprimtari dhe mbështetje shpirtërore për stoicizëm e qëndresë gjatë vuajtjes, keqtrajtimeve dhe burgosjeve të paseshura të të rinjve atdhetarë e lirisdashës.

101. Hasan Mekuli, kritik letrar: Adem Demaçi është i lidhur me traditën

Vepra "Gjarpinjtë e gjakut" e Adem Demaçit nuk është vetëm libër i ri, por dëshmi e re për përparimin dhe pjekurinë e tij, dëshmi e re për faktin se Demaçi është i lidhur bukur fort dhe në mënyrë vet për traditën.

102. Hasan Ukëhaxaj, veprimtar i çështjes kombëtare: Për Adem Demaçin dituria ishte primare

Adem Demaçi kërkon nga bashkëkombësit që të pajisen me dije, sepse ajo është çelësi i përparimit; grishje kjo si e poetit kombëtar Naim Frashëri, i cili para më se një shekulli lëshonte kushtrimin "Vetëm dritë e diturie përpara do na shpjerë".

103. Hashim Thaçi, kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës: Adem Demaçi, simbol i pavarësisë së Kosovës

Qeveria e Kosovës ka vendosur që: ish-Përfaqësuesi Politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe simboli i pavarësisë së Kosovës, Adem Demaçi, të ketë pagë mujore, e njëjtë me kryeministrin, nga bux-

heti i Zyrës së Kryeministrit; të ketë veturë dhe vozitës; ndërsa shtëpia ku ai ka vepruar gjatë kohës së luftës të shpallet Shtëpi muze.

104. Helena Kadare, shkrimtare: Adem Demaçi, i burgosuri politik më i famshëm ndër shqiptarët

Letra e hapur e datës 2 nëntor, me të cilën Adem Demaçi i drejtohej Ismail Kadaresë, ishte pa dyshim mesazhi më tronditës. Letra kishte një peshë të veçantë, nga që ishte dërguar nga i burgosuri politik më i famshëm ndër shqiptarët, njeriu që kishte qëndruar rreth tridhjetë vjet në qeli dhe që njihej si Mendela i Kosovës. Ismaili mendonte se ai ishte më shumë se Mendela.

105. "Historia e popullit shqiptar": Adem Demaçi synonte bashkimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi me Shqipërinë

Organizata e drejtuar nga gazetari dhe shkrimtari Adem Demaçi quhej "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", qysh në nenin e parë të Programit të sajë thuhej: "Qëllimi i parë dhe i fundit i lëvizjes sonë është sigurimi i të drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banueshme me në shumicë prej shqiptarësh, që gjinden ende nën administrimin e Jugosllavisë, d.m.th. qëllimi i parë dhe u fundit i lëvizjes sonë është çlirimi i krahinave shqiptare, t'aneksueme prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nanën e vet - Shqipërinë".

106. Hugues Dorz, gazetar belg: Adem Demaçi, Mendela i Ballkanit Kosova një provincë në jug të Serbisë, e banuar me mbi 90 % me shqiptarë, jeton nën pushtimin serb. Vendi është në tension dhe situata ekonomike është shumë e ulët. Adem Demaçi, simbol i rezistencës shqiptare të cilin e quajmë Mendela i Ballkanit, aktualisht është në Belgjikë. Ka ardhur për ta bindur komunitetin ndërkombëtar që ta përkrahin çështjen shqiptare.

107. Hydajet Hyseni, kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës: Adem Demaçi ishte dënuar me të lindur

Kur flitet për Adem Demaçin përmenden në mënyrë të pashmangshme tri gjykimet e tij të padrejta, tri deceniet e burgut të tij të gjatë dhe të rëndë. Në të vërtetë, siç thekson edhe vet Adem Demaçi, ai dhe Brezi i tij, ashtu si edhe Brezat para e pas tij, ishin dënuar me të lindur.

108. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës: Për Adem Demaçin letërsia asnjëherë nuk ishte preokupim jetësor

Në aksionin gjithëpërfshirës të Adem Demaçit letërsia është vetëm një trajtë e angazhimit. Ndonëse një veprimtari që nis qysh në rininë e autorit dhe madje e frytshme e me një shtrirje prurësh deri në ditët e sotme, letërsia asnjëherë nuk ishte preokupim jetësor i tij. (Vijon)

SOT, ME 14 SHKURT 2017 BËHEN NJËMBËDHJETË VITE DHIMBJE
E PIKËLLIMI NGA VDEKJA E MË TË DASHURIT TONË



HAXHI IBRAHIM (SHYQRI) DEVOLLI

(1943-2007)

VITET IKIN E DHIMBJA PËR TY NUK LARGOHET. PIKËLLIMI VETËM SA VJEN E SHTOHET,
MALLI ASNJËHERË NUK SHUHET. GJITHMONË DO TË JEMI KRENAR QË TË PATËM.

TË PËRKUJTOJNË ME MALL:

Bashkëshortja: Nazlija

Djali: Blerimi

Reja: Donalda

Mbesat: Vlera, Erëza, Jona

11 VJET PA VËLLAUN, KUNATIN
DHE AXHËN TONE TË DASHUR



HAXHI IBRAHIM (SHYQRI) DEVOLLI

(1943-2007)

Jetojmë dhe mburemi për veprat tua, jemi krenar që të patem. Prehu i qetë në perjetësi se ne do vazhdojmë rrugen ashtu si doje Ti.

TË PËRKUJTOJNË ME MALL:
Vllau: Haxhi Shyqri Devolli
me familje.


E jashtëzakonshme

Rruga që t'i merr mendtë

Për banorët e Chongqingut në Kinë, rruga e kthimit në shtëpi është shpesh e sikletshme. Për të hyrë në një kompleks rezidencial duhet të bësh një rrugë spirale që kohët e fundit është bërë virale në internet. Kjo rrugë t'i lodhë nervat vetëm kur e shikon, kështu që imagjinoni se çfarë mund të ndiejnë ata banorë që duhet ta përshkojnë çdo ditë.



FOTO E DITES



Ish-presidenti Barack Obama dhe bashkëshortja e tij Michelle Obama kanë marrë pjesë në prezantimin e portreteve të tyre zyrtarë në Galerinë Kombëtare të Portreteve në Uashington DC.

E rrallë

Babai ndërton një krevat princeshash për vajzën e tij

Brandon Taylor e gjeti veten duke ndërtuar një krevat princeshash për vajzën e tij tetëvjeçare. Vajza i ishte lutur t'i blinte një që ishte shumë i shtrenjtë ndaj ai vendosi t'ia ndërtonte me duart e tij. "Ajo më dërgoi një fotografi të një krevati që kushtonte afërsisht 3 200 dollarë dhe 500 dollarë shtesë për transportin. Kështu që e ndërtova vetë", ka thënë Brandon për "Love What Matters".



BARSOLETA E DITËS



- O zotëri taksist, a po keni punë?
- Sa me mbet gjallë.
- Pse mos deshe me taksi të bëhesh milioner?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

"FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.

Regjia: James Foley



Në ora 22:00 (PG-13)

"THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Jeni mësuar t'i kryeni të gjitha punët herët në mëngjes në mënyrë që dita t'ju nis mbarë. Sot një problem i vogël do ta shtyjë përpara kohën.



DEMI

Sinqeriteti juaj mund të keqpërdoret nga ata persona që i keni menduar të afërt. Zhgënjimi do t'ju bëjë me të kujdesshëm në të ardhmen.



BINJAKËT

Partneri është personi tek i cili besoni më shumë. Do të anashkaloni një mik të mirë që do të mërzhitet me ju.



GAFORRJA

Nëse keni vendosur të ndryshoni diçka në punën tuaj këtë gjë nuk mund ta bëni pa miratimin e partnerëve ose kolegëve.



LUANI

Keni ditë që po mundoheni të komunikoni me një person, por pa ia arritur qëllimit. Nuk po e kuptoni këtë shmangie prej tij.



VI RGJËRESHA

Sot ditë e zymtë do të jetë. Ndihehi të plogësht dhe nuk doni të merrni asnjë iniciativë në asnjë fushë.



PESHORJA

Keni plane të mëdha për të ardhmen, por për momentin nuk doni të prononcoheni. Po prisni kohën e duhur.



AKREPI

Dita sot do t'ju tregojë se jo gjithmonë mund të nxitoni për t'i realizuar qëllimet tuaja.



SHIGJETARI

Ata që mendonit se po ju pengonin do t'ju tregojnë se ju janë gjendur shumë pranë. Duhet të kërkonit falje për paragjykimin tuaj.



BRICJAPI

Sot doni të bëni shumë gjëra pa menduar mjetet që keni në dispozicion. Kjo do t'ju krijojë vështirësi.



UJORI

Jeni të dyzuar midis ndjenjës dhe arsyes sot. Duke qenë mjaft impulsive, do ta dëgjoni zemrën dhe jo mendjen.



PESHQIT

Dita paraqitet e qetë dhe ju ndiheni të përkëdhelur sot. Keni ikur diku larg me mendime.

Rrugëtimi drejt vargjeve poetike



Mr. Kosovare KRASNIQI

Enis Miftari është një emër i ri, i cili me librin e tij të parë "Rrugëtimi im" po hyn në botën e magjshme të artit letrar në fushën e poezisë. Edhe pse Enisi është i ri në moshë, dhe duke pasur parasysh se libri në fjalë është vëllimi i tij i parë, muza e tij udhëton brenda e jashtë atdheut të tij nëpër të gjitha shtigjet. Zëri i tij në poezi del si një "klithmë dashurie" për tokën amtare të tij, për bashkëvendësit dhe, në fund, edhe për dashurinë e tij. Në vargjet e këtij vëllimi, ne përballemi plotësisht me botën objektive në të cilën jetojmë. Përshkruan rrethanat dhe ngjarjet tronditëse me të cilat përballlet vendi i tij, dhe në këtë rast duhet të theksoj se poeti i ri

Enisi vjen nga Gostivari, qytet ky, ku pos burimit të bukur të Vardarit, është edhe vend i përjetimeve të rënda, dhe njëra ndër to, ishte ikja e të rinjve nga qyteti. Një përshkrim të tillë të ngjarjes e paraqet subjekti lirik i poezisë "Robëri", i cili mbetet udhëtar "i shpresës së thyer", sepse është i detyruar të jetojë në shkretëtirën e padrejtësive: I robëruar po jetoj dhe këto pak ditë

Të ardhmen e shoh në Evropë tek po shkëlqen atje një dritë. Poezia ndërtohet mbi një mikrofabulë reale jetësore, andaj e gjithë ajo përshkohet nga nota të thella proteste për largimin e të rinjve nga atdheu i vet, momente këto të cilat e shqetësojnë autorin.

Me pak fjalë, autori në vëllimin e tij nuk i shmanget problematikes aktuale të kohës. Ai nuk ngurron të shkruajë për atë që e mundon shoqërinë tonë dhe pos që paraqet dhembjet që e mendojnë popullin shqiptarë të Maqedonisë, ai nuk e harron edhe pjesën tjetër të kombit të ndarë shqiptar, Kosovën. Siç thotë Kuteli

"Atdheu është atdhe edhe atëherë kur të vret", por në poezitë e tij nuk ndiejmë nota të zhgënjimit dhe melankolisë, sepse zëri i tij del zë i guximit dhe i shpresës për një të ardhme më të mirë. Ky zë i shpresës del tek poezia "Një ditë e re":

Do vazhdoj të ecja përsëri me krenari mbi veprat jam thirrës i të vërtetës edhe po të më thyeni eshtrat Në një ditë të re që armiqtë do i konsideroj dhuratë lutem për ata që jetojnë sot e më gjatë.

Jeta bëhet nga poezia, thotë Borhesi, dhe Enisi, poeti i ri, ka ditur të depërtojë dhe ta konkretizojë këtë realitet në subjektin e çdo poezie, si në ato momentet e lumtura, por edhe në ato të dhembshmet, që të ofron jeta.

Enisi, si shumë të tjerë, rrugëtimin e tij drejt artit letrar e nisi përmes gjinisë së bukur artistike dhe letrare, poezisë.

Ndër lirikën e tjera të bukura të këtij vëllimi janë edhe poezitë me temë erotike apo të dashurisë, të cilat i mbledh në

një cikël të veçantë titulluar "Portreti yt në vargje". Autori në vëllimin e tij poetizon gjendje të veçanta, tronditje shpirtërore, pranë dhe larg të dashurës së tij. Në çdo poezi të këtij cikli, paraqet gjendjen e tij emocionale dhe shpirtërore, atëherë kur subjektin lirik i bënte shoqëri hëna, ajo, imagjinohej dhe portretizohej në vargjet e tij deri në atë masë, sa ai i betohet se do i mbes dielli i saj i vetëm:

Do takohemi, për ëndrrat që thurëm për ato fjalë që nuk thuhet. Sot apo nesër do takohemi në të dy.

do mbetem gjithmonë dielli i vetëm për ty.

Dhe, duke i kërkuar falje që ishte i detyruar ta braktisë, dhe që nuk mundi të bëjë atë që duhet bërë, ndoshta ta dojë më tepër, ashtu sikurse bën edhe Fatos Arapi në poezitë e tij, ta kishte pranë, t'i mbështetej në kraharor, po për subjektin lirik dashuria mbetet e paharruar:

Erdha të të takoj, por në gjumë të thellë ishe Shpirtin tënd të butë, nuk dua

ta trazoj butësinë e ëmbël që në fytyrë kishe nuk do mundem ndonjëherë ta harroj.

Përfundim

Tema qendrore ku fokusohet më shumë poezia e këtij vëllimi është klima e rëndë që e zotëron në vendin e tij. Gjendja shpirtërore e poetit pasqyrohet përmes motiveve të ndryshme. Në poezitë e tij eksplorohej gjendje dhe situata nga më të ndryshmet. Në poezi, pos që manifestohet dashuria për kombin dhe lirinë, gërshetohen edhe anët emocionale si ëndrra, gëzimi, trishtimi, malli dhe vetmia. Fryma e lirisë së shprehjes dhe qartësia, poezinë e Enisit e bën më të kuptueshme. Ajo është poezi që ndjehet dhe kuptohet mirë nga lexuesi dhe kam bindjen se Enisi, duke u frymëzuar nga ide dhe ngjarje të reja, si brez i ri i poezisë, nuk do të ndalet me kaq, por do na sjellë edhe vëllime tjera, që do të jenë pa dyshim edhe më të bukura se këto të vëllimit të parë.

Thaçi: Ganiu me saktësi shpalosi vlerat e organizimit politik kundër sundimit jugosllav

Gani Sylajn, e përgëzova me rastin e botimit të librit të tij "I-legal viteve shtatëdhjetë". E kam lexuar si dorëshkrim këtë libër biografik që është biografi e lëvizjes atdhetare të viteve 1970/79, ka thënë Thaçi.

PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidenti Hashim Thaçi ka përgëzuar ish të burgosurin politik Gani Sylajn për botimin e librit të tij "I-legal viteve shtatëdhjetë". Thaçi ka thënë se në këtë libër Sylajn me saktësi të madhe ka shpalosur vlerat e organizimit politik kundër sundimit jugosllav të Kosovës dhe rrethanat politike që çuan drejt demonstratave të vitit 1981. "Veprimtarin e shquar, ish të burgosurin politik, Gani Sylajn, e përgëzova me rastin e botimit të librit të tij 'I-legal viteve shtatëdhjetë'. E kam lexuar si dorëshkrim këtë libër biografik që është biografi e lëvizjes atdhetare të viteve 1970/79. Ganiu me saktësi të madhe shpalos vlerat e organizimit politik kundër sundimit jugosllav të Kosovës, rrethanat politike që çuan drejt demonstratave të vitit 1981 si bën portretizimin e një galerie të personaliteteve që mbajtën të pashkëputur lëvizjen çlirimtare. Nga Ganiu presim botimin e kujtimeve të plota", ka thënë Thaçi.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE PORTO - LIVERPOOL GG3+ REAL MADRID - PSG GG3+ OSNABRUCK - KARLSRUHE GG3+

Debutim i suksesshëm i Tahirit në 'PyeongChang 2018'

Skitari Albin Tahiri është i kënaqur me debutimin që bëri në LOD "PyeongChang 2018". "Unë jam vërtet i lumtur me garën e lëshimit pavarësisht prej disa gabimeve që bëra. Sllallomi ishte shumë i vështirë, shumë me akull, por ia dola të arrij në cak dhe zënia e vendit 37 ishte rezultat që e kam pritur", ka thënë Tahiri



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 13 SHKURT - Skitari që po merr pjesë në Lojërat Olimpikë Dimërore "PyeongChang 2018", Albin Tahiri, ka debutuar me plot sukses në këto lojëra. Në garën e lëshimit, Tahiri doli i 56-ti me kohë 1:23.84 sekonda, kurse në disiplinën kombinim alpin e ka zënë vendin e 37 nga 65 garues. Duke pasur parasysh edhe kushtet që kanë mbretëruar, ky rezultat i Tahirit është vlerësuar mjaft pozitiv sepse shumë garues nuk kishin mundësi të përfundonin garën. Pas garës Tahiri për faqen

zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) ka thënë se është i lumtur për rezultatit e arritur në këto lojëra. "Unë jam vërtet i lumtur me garën e lëshimit, pavarësisht disa gabimeve që bëra. Sllallomi ishte shumë i vështirë, shumë me akull, por ia dola të arrij në cak dhe zënia e vendit 37 ishte rezultat që e kam pritur", ka thënë Tahiri.

Ndërsa trajneri Agim Pupovci është shprehur i kënaqur me garën e lëshimit që ka bërë skitari nga Kosova, por jo aq shumë edhe me atë të sllallomit. "Ishte gara e parë e Albinit në kombinim alpin. Ka qenë garë shumë e fortë. Terreni ishte i ngrirë prej

katër ditësh, ku është punuar edhe me injeksion (mbushje me ujë). Në lëshim ka qenë shumë i mirë, rreth 4.60 sekonda larg vendit të parë, ku u plasua si i 55-ti, kurse në sllallom ishte

terreni shumë i vështirë. Por, pasi bëri dy gabime të forta, humbi shumë kohë dhe u plasua në vendin e 37 prej 65 garuesve. Me lëshim jam i kënaqur, por me sllallom, po të mos ishin këto dy

gabimet e mëdha, do të ishte plasmani më i mirë", ka deklaruar Pupovci. Garën e radhës Tahiri e zhvillon nesër (e enjte) në garën e lëshimit.

Trepça '89 - Llapi, derbi i Kupës

Prishtinë, 13 shkurt - Sot (e mërkurë) rikthehen ndeshjet e futbollit në kuadër të 1/8 së finales në Digital Kupën e Kosovës. Ndeshja kryesore e këtij rrethi zhvillohet në stadiumin "Riza Lushta", ku skuadra kampione, Trepça '89, e pret kampionen vjeshtore, Llapin. Një tjetër ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në stadiumin e qytetit në Therandë, ku Ballkani nga Liga e Parë e pret skuadrën e Gjilanit. Drita i shkon Istogut, kurse Prishtina luan ndaj rivales lokale, Kosovës së Prishtinës. Të gjithë ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen me fillim nga ora 12:30.



1/8 e Kupës: Ballkani ? Gjilani, Trepça '89 ? Llapi, Vëllaznimi ?

Rahoveci, Drenica ? Arbëria (Dobrajë), Vushtrria ? Liria, Istogu ? Drita, Prishtina ? Kosova e Prishtinës.

Raikkoneni: Do t'jua tregoj historinë time

HELSINKI, 13 SHKURT - Me titullin "Do t'jua tregoj historinë time" do të dalë në treg në muajin gusht biografia e pilotit finlandez të Formulës 1, Kimi Raikkonenit. Në libër, kampioni i Botës në vitin 2007 do të tregojë shumë nga përvojat e veta. Kjo biografi pritet me interes pasi Kimi Raikkoneni është një nga pilotët më të mbyllur.



"Idealja do të ishte sikur të pilotoje një makinë F1 në mënyrë anonime. Një i panjohur mund të rruhet ose ta presë

barin, por nuk mund të pilotojë një makinë garash", shpjegon në libër Kimi Raikkonen. Për librin thuhet se është "i egër, humoristik dhe mallëngjyes, që i hap derën e argëtimit atyre që nuk janë të interesuar për makinat".

Sytë kah derbi Real - PSG

MADRID, 13 SHKURT - Paris Saint Germain, i përforcuar në afatin kalimtar të verës me yllin brazilian, Neymar, nga Barcelona, sonte (e mërkurë) e ka sfidën e parë serioze në

këtë edicion, ku në 1/8 e finales së Ligës së Kampioneve i shkon Real Madridit në "Santiago Bernabeu". Reali është duke kaluar nëpër një krizë rezultatesh në kampi-

onat dhe tashmë duket e sigurt se e ka humbur garën për titull dhe të gjithë shpresat i ka në garën ku e mban primatin e kampiones, kurse në anën tjetër PSG-ja ka një ecuri të

mirë në kampionat dhe tash synon të marrë një rezultat të favorshëm para ndeshjes së kthimit. Ndeshja tjetër që zhvillohet është ajo në mes të Portos dhe Liverpoolit.



Lacazette mungon gjashtë javë

LONDËR, 13 SHKURT - Sulmuesi Alexandre Lacazette do të qëndrojë për të paktën gjashtë javë larg fushave pasi i është nënshtruar një operacioni në

gju. Këtë lajm e ka konfirmuar klubi londinez, që tani ka mbetur pa një qendërsulmues të mirëfilltë në Evropa Ligë. Një deklaratë për shtyp e klu-

bit ditën e martë zbulon: "Sulmuesi Alex Lacazette ka një artroskopi në gjurin e majtë në Londër mëngjesin e së martës. Procedura kishte

sukses dhe ai tani do ta fillojë periudhën e rehabilitimit. Parashikohet që ai të rikthehet në skuadër pas katër deri gjashtë javësh".



Golden State hipotekon kreun në Perëndim



OAKLAND, 13 SHKURT - Skuadra kampione e Golden States arriti fitoren e 45-të sezonale në NBA, pasi triumfoi me rezultat 129-83 ndaj Phoenixit. Curry me 22 pikë ishte shënuesi më i mirë, mbështetur nga Casspi, autor i 19 pikëve dhe 10 rebaundeve, ndërsa 29 pikët e Paytonit për miqtë mbetën për statistikë. Humbja e dytë radhazi për San Antonion, që u mund në sekondat e fundit 101-99 nga Utah Jazzi, sfidë ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Mitchell me 25 pikë ishte shënuesi më i mirë për Jazzin,

ndërsa për Spursin nuk mjaftuan 15 pikë e 15 rebaunde të Pau Gasolit, raporton "Telesport". Një fitore shprese për një vend në "play-off" korri skuadra e Chicagos, që e mposhti 105-101 Orlandon, takim me emocione në minutat e fundit. Markkaneni me 21 pikë bëri diferencën në fushë për Bulls-in, ndërsa për miqtë 24 pikët e Hezonja dhe 22 të Fournierit mbetën për statistikë. Moment i mirë për Clippersat, që mundi 114-101 Brooklynin jashtë fushës, me Lou Williamsin që realizoi 20 pikë, më

i miri në parket për miqtë. Pa probleme fiton edhe New Orleansi, që mundi 118-103 Detroitin (Davis 38 pikë e 10 rebaunde), ndërsa Philadelphia mposhti 108-92 New Yorkun (Saric 24 pikë).

REZULTATET

Detroit - New Orleans	103-118
Philadelphia - New York	108-92
Brooklyn - Clippers	101-114
Chicago - Orlando	105-101
Utah Jazz - San Antonio	101-99
Golden State - Phoenix	129-83

Ish-mesfushori anglez: Vinim baste të çmendura në kombëtare

LONDËR, 13 SHKURT - Kieron Dyer ka zbuluar pa asnjë rezervë në autobiografinë e tij të fundit për kulturën e basteve të futbollistëve në Angli dhe pranon se disa prej tyre ishin me të vërtetë të varur. Ish-mesfushori i Ipswich Townit, West Ham Unitedit dhe Newcastle Unitedit pranon në librin e tij që po serializohet nga "Daily Mail", se bastet ekzistojnë në nivelin më të lartë të futbollit, edhe brenda kombëtares angleze. "Ishim bërë si pijanecë klandesitë, që fshiheshim për të mos luajtur. Përveç drogave, një pjesë e mirë e jona ishte e varur edhe nga bixhozi. Kishte katër apo pesë lojtarë në kombëtare që luanin, por shumat ishin aq të larta sa nuk dua që të përmend emra. Nuk kishte asnjë kufi për atë çka vinim". 39-vjeçari, i cili regjistroi 33



ndeshje me fanellën e përfaqësueses, tregon se vuri një bast me Owenin që Koreja e Jugut do ta mposhte Italinë në Botërorin e 2002-s. "Pas Botërorit, Oweni më kishte një borxh prej 30 mijë sterlinash, duke luajtur letra në hotel.

Më vinte keq për të. Për ta paguar borxhin ishte ofruar për ta bërë mbajtësin e basteve të Botërorit në Japoni. Unë vendosa që Koreja eliminon Italinë dhe borxhi i tij u shtua me 8 500 paund", ka deklaruar ai.

SHKURT

Hirscheri fiton medaljen e parë të artë olimpike

Kampioni austriak Marcel Hirscher, pas 120 podiumeve në Kupën e Botës, 55 fitoreve dhe 6 titujve, pas 3 medaljeve të arta në Kampionatet Botërore dhe një argjendi në Olimpiadë, më në fund ia doli mbanë të fitojë edhe një medalje të artë në Lojërat Olimpike. Legjenda e garave me ski triumfoi sot në disiplinën e "të kombinuarës" (sllalom dhe super-gjigant) në "Pyeongchang 2018", duke dominuar në pistë në të dyja zbritjet. Ai dha kohën e përgjithshme 2'06"52, duke lënë pas dy rivalët francezë, Alexis Pinturault dhe Victor Muffat, respektivisht medalje argjendi dhe bronzi në Olimpiadë. Për sa i përket garës, ajo u zhvillua në një pistë më të shkurtër nga parashikimi, për shkak të kushteve jo të mira atmosferike, por kjo nuk ndaloi Hirscher të triumfojë dhe ta bëjë realitet ëndrrën, duke fituar medaljen e parë të artë në një Olimpiadë.

Virtus Entella prezanton Llullakun

Reprezentuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Azdren Llullaku, është zyrtarizuar si transferi i ri i skuadrës së Virtus Entellas. Lajmin e ka konfirmuar vetë skuadra nga Seria B, kurse për sulmuesin është një rikthim në Itali, pas një përvoje të Gaz Metanit dhe Astanës. 29-vjeçari për kombëtaren kuqezi ka regjistruar gjashtë paraqitje.

Zbulohet rasti i parë i dopingut në Lojërat Olimpike

Shënohet rasti i parë me doping në Lojërat Olimpike Dimërore që po mbahen në Pyongchang. Patinotori japonez Kei Saito është konstatuar të ketë përdorur substancat e ndaluara acetalozamide dhe agentët e antidopingut i kanë kërkuar që të largohet nga Fshati Olimpik, i përjashtuar nga aktiviteti. 21-vjeçari Saito, i cili është i pari sportist japonez që konstatohet të ketë përdorur substanca të ndaluara në Lojërat Olimpike, rezultoi pozitiv në testin e bërë përpara fillimit të aktivitetit. "Do të luftoj për të provuar që jam i pafajshëm. Jam i surprizuar, sepse nuk kam përdorur asnjëherë substanca doping", deklaroi sportisti.

Ferizaj e mposhti Malishevën

Skuadra e Ferizajt në ndeshjen miqësore të zhvilluar në Durrës e ka shkatërruar skuadrën e Malishevës, pasi e mundi me rezultat bindës 5-0. Shënues për skuadrën e drejtuar nga Bylbyl Sokoli ishin Avdyl Haliti me dy gola dhe nga një tjetër shtuan Armend Misini, Fillim Guraziu dhe Nazif Mulaku. Ferizaj sot (e mërkurë) rikthehet nga Durrësi për ta vazhduar në Kosovë fazën e tretë përgatitëse për sezonin pranveror.

Guti: Dua ta shoh Neymarin në Real

Neymari u largua nga Barcelona për Paris Saint-Germainin për një shumë rekord në vlerë 222 milionë euro vitin e kaluar, por ylli brazilian tashmë lidhet me një kalim të mundshëm në Real Madrid. Trajneri i të rinjve në Real, Guti, dëshiron ta shohë Neymarin së bashku me Ronaldon duke luajtur për "Los Blancos". "Neymari është ndryshe. Ai është në mesin e tre futbollistëve më të mirë në botë. Çfarë duam është t'i shohim më të mirët në botë. Pra, çfarë dua të shoh është Neymarin dhe Ronaldo të veshur bardh", ka thënë Guti.

Perez: Nëse largohet Ronaldo, do ta transferoj Messin

Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, e kishte paralajmëruar Cristiano Ronaldon se nëse do ta braktiste gjigantin spanjoll për Paris Saint-Germainin, atëherë ai do ta blinte Lionel Messin për 200 milionë euro, sipas revistës franceze të futbollit "France Football". Perez i ka thënë një shoku se në rast të largimit të Ronaldos, do ta sjellë Messin në "Santiago Bernabeu". "Dua të shkoj në Paris. Atje do të më duan vërtet. Francezët do të jenë shumë të lumtur që luaj në kampionatin e tyre sa që mediat do të bëjnë fushatë në favorin tim për ta fituar "Topin e Artë", kishte thënë Ronaldo në mesazhin e tij dërguar një miku.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJIS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR

AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE

AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:83 /1

Dt: 13.02.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional .04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni4), Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

VAZHDIM I KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për nivelin e V-të të arsimit i cili do të ofrohet në Qendrën e Kompetencës në Prizren, vazhdimi i konkursit vlen për grupin e ndarë në Prishtinë për vitin shkollor 2017/2018

Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Prizren	2 (dy) Mësimdhënës/e me gjysme norme për kualifikimin "Këshilltar karriere", kualifikim ky i cili do të ofrohet në paralelen e ndër në grupin në Prishtinë për nivelin e V-të të arsimit	Vendi i lirë për një (1) vit shkollor)

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënësit e nivelit të V-të arsimit ;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me standartin e profesionit dhe programin mësimor;
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislativonin në fuqi;
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së;
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë;
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve;
- Nëse punon me orar të plotë nuk ka të drejtë të punojë në ndonjë punë apo detyrë me pagesë nga Buxheti i Kosovës;
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të kandidatëve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;

- Kontribuon në ofrimin e shërbimeve për këshillim të karrierës në Qendrën e Kompetencës, duke përfshirë edhe përdorimin e të gjitha pajisjeve të sistemit të informimit;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në aktivitetet e përgjithshme të monitorimit dhe vlerësimit në Qendrën e Kompetencës;
- Bënë hulumtime specifike për fushën/kualifikimin më qëllim të ngritjes se cilësisë dhe transferimin e njohurive dhe shkathtësive adekuate te kandidatët;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të bashkëpunojë rregullisht me organin drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe akterët përkatës, në mënyrë që t'i realizojë marrëveshjet formale të bashkëpunimit me partnerët e organizatës duke përdorur veprat adekuate juridike për t'i arritur qëllimet e synuara;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

Kualifikimi, shkathtësitë dhe dokumentacioni i kërkuara:

- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master në Menaxhimin dhe Zhvillimin e Resurseve Njerëzore, Master në Udhëzim dhe Orientim në Karrierë ose kualifikim i përafërt;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimin e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punësnëarsim;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë trajnuar dhe certifikuar nga PEARSON;**
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërta në afat të caktuar.

Aftësitë shtesë

- Niveli të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
 - Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
 - Të jetë mendje-hapur në idë dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 8 ditë pas shpalljes. Aplikacionet për dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dozohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MASHI-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga ueb-faqen e Agjencisë <http://aaaparr.rks-gov.nct/>.

Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni liridona.shala@rks-gov.net nr.tel 038 200 20 198, prej orës 08:00-16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Uredbe MF-br. 05/2017 o izmeni i dopuni Uredbe MF-br. 01/2016 o upravljanju fondovima pozajmljivanja, izmenjen i dopunjen Uredbom MF-br. 03/2017, Zakona br. 03/L-175 o javnim dugovima (Službeni list Republike Kosovo, br. 65, 5. februar 2010. godine), Ministarstvo trgovine i industrije objavljuje:

Objava interesovanja za poziciju
Službenik za finansijsko upravljanje i nadgledanje
Projekat "Konkurentnost i spremnost za Izvoz"
(P152881)

UVODNA INFORMACIJA

Vlada Kosova je blisko saradivala sa Svetskom Bankom na pripremanju projekta Konkurentnost i spremnost za izvoz. Projekat će imati 15.3 miliona dolara (ekvivalentna vrednost u evrima) i njegov razvojni cilj (RC ili na engleskom *PDO-Project Development Objective*) će biti podrška sertifikovanja proizvoda za izvozna tržišta, jačanje kapaciteta kompanija orijentisanih ka izvozu kao i smanjenje troškova inspekcije poslovanja. Projekatima dve komponente: 1. Unapređenje poslovnog okruženja i spremnost za izvoz; 2. Podrška oko sprovođenja i koordinacije projekta.

Ministarstvo trgovine i industrije (MTI) će biti odgovorno za sprovođenje projekta. Jedinica za sprovođenje projekta (JSP) će biti osnovana u MTI. JSP će pružiti podršku MTI-u u efektivnom i pravovremenom sprovođenju projekta. JSP će biti odgovoran za podržavanje Ministarstva u svim procedurama nabavke, finansijskom upravljanju, nadgledanju i procenjivanju kao i izveštavanju o korišćenju fondova za sprovođenje projektnih aktivnosti.

CILJ ZADATKA

Glavni cilj ove pozicije je pomaganje Projektu i nadležnom Odeljenju MTI-a u relevantnim aktivnostima projekta tokom sprovođenja primenljivih procesa finansijskog upravljanja u potpunom skladu sa odredbama Finansijskog sporazuma koji je potpisan između IDA (Svetska Banka) i Vlade Kosova i procedurama koje su opisane u Projektnom operativnom priručniku (POP).

DELOKRUG RADA

Obaveze i odgovornosti:

Ekspert za finansijsko upravljanje i nadgledanje će biti odgovoran za sledeće zadatke:

- U saradnji sa Odeljenjem za budžet i finansije MTI-a, kreira i održava sisteme finansijskog upravljanja, u skladu sa Sporazumom o kreditu.
- Obavlja sve neophodne poslove u vezi sa planiranjem, kompenzacijom, isplata, računovodstvom i finansijskim izveštavanjem u koordinaciji sa MTI-om i Ministarstvom ekonomije i finansija (MEF).

Generalno, specifični zadaci koji se trebaju preduzeti od strane konsultanta obuhvataju, ali se ne ograničavaju na, praktičnu pomoć u:

- Nadgledanju i osiguravanju efektivnog korišćenja fondova Projekta u skladu sa Sporazumom o kreditu, Procedurama Svetske Banke i Kosovskim Zakonodavstvom;
- Doprinošenju pitanjima koja se odnose na Finansijsko upravljanje u pripremanju Projektnog operativnog priručnika i Priručnika o grantovima;
- Osiguranju da okruženje interne, pouzdane i efikasne kontrole bude unutar MTI-a, JSP-a i KIESA-e oko projektnih troškova i u skladu sa Projektnim operativnim priručnikom i Operativnom priručniku o grantovima.
- Doprinošenju u procesu planiranja i budžetiranja projektnih aktivnosti, kao i pripremanju relevantnih prognoza;
- Razmatranju, verifikaciji i procesu usvajanja svih zahteva za plaćanje projektnih troškova finansiranih od strane IDA Credit.
- Verifikuje fakture i prateće dokaze o projektnim troškovima radi slaganja sa uslovima ugovora i sporazuma;
- Blagovremeno obezbeđuje izvršenje isplata za snabdevače, ugovarače i konsultante, ili druge korisnike u skladu sa uslovima ugovora i sporazuma;
- Obezbeđuje da se tačni podaci projektnog računovodstva čuvaju u sistemu Free Balanca/Trezora, potvrđujući tačnost i potpunost svih transakcija;
- Redovno podnošenje celokupne finansijske dokumentacije (obraci za zalaganje i plaćanje, računi, dokumentacija prijema i usvajanja, ostali prateći dokazi, podnesci i izveštaji za sve vrste troškova projekta, uključujući kompatibilne grantove i poslovna putovanja);
- Priprema aplikacije za isplatu na osnovu zahteva Pisma o akreditivu i Sporazuma o kreditu;
- Periodično upravljanje inventarom fizičkih/fiksni sredstava tokom projekta;
- Priprema povremene ne-revidirane tromesečne finansijske izveštaje i godišnje finansijske izveštaje o projektu kao i blagovremeno ih podnosi Svetskoj Banci;
- Izraduje inpute u vezi sa upravljanjem finansija za Izveštaj o napretku projekta;

- Priprema mesečne i tromesečne finansijske izveštaje za projektne operacije, zahtevane od strane MTI-a, Ministarstva finansija, Poreske Administracije Kosova i ostalih vladinih institucija;
